



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS**  
APELACIONI SUD KOSOVO – THE APPELLATE COURT OF KOSOVO

---

**RAPORTI VJETOR I PUNËS I GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS**

**PËR VITIN 2018**

## **HYRJE**

Ky raport vjetor i punës së kësaj gjykate paraqet të gjitha rezultatet dhe sukseset e arritura, por edhe sfidat, vështirësitë dhe pengesat me të cilat kjo gjykatë është përballur gjatë këtij viti.

Raporti është i bazuar në të dhëna reale dhe të sakta statistikore për numrin e lëndëve të trashëguara nga viti paraprak i punës, lëndët e arritura dhe lëndët e përfunduara brenda vitit 2018, duke përfshirë edhe numrin e lëndëve të papërfunduara të cilat do të barten në vitin pasues.

Raporti paraqet edhe aktivitetet tjera të gjykatës të realizuara gjatë këtij viti e të cilat kanë pas ndikim në rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës.

Përmes këtij raporti janë paraqitur edhe disa nga sfidat dhe vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar në punën e kësaj gjykate.

Si pikënisje për të vlerësuar realisht punën e kësaj gjykate kanë shërbyer objektivat e projektuara dhe të përcaktuara paraprakisht me Planin vjetor të punës për këtë vit, Planet periodike si dhe ato të përcaktuara me ligj dhe aktet normative të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pjesën që kanë të bëjnë me Gjykatën e Apelit, siç janë:

- Ligjit për Gjykatat Nr.03/L-199 (Gazeta Zyrtare 79/24, datë 24.08.2010);
- Rregulloren për Organizimin e Brendshme të Gjykatave( KGK 2013);
- Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën e Apelit nr.04/2015;
- Shtojcën e Rregullores së KGJK-së për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave ;
- Udhëzimin 01/2015 i KGJK-së për delegimin e përgjegjësive në çështje të personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës.
- Planit Vjetor të Punës për gjyqtarët dhe administratën e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të miratuar nga Kolegjiumi i Gjyqtarëve me 05.03.2018.
- Raportet mujore për efektet e punës së gjykatës në tërësi dhe secilit gjyqëtar veç e veç.
- Raportet mujore për arritjen e lëndëve të reja në gjykatë dhe
- Aktet tjera të rëndësishme për gjykatën.

## I. LËNDËT

### 1. Vështrim i përgjithshëm

Vitin 2018, Gjykata e Apelit e ka filluar më 12 mijë e 576 lëndë të trashëguara. Gjatë tërë vitit kanë arritur edhe 14 mijë e 28 lëndë, shifër kjo më e madhja e regjistruar ndonjëherë, që do të thotë kemi pasur në punë, gjithsej **26 mijë e 604**. Prej tyre, gjykata ka arritur t'i zgjidh 13 mijë e 648 lëndë, ndërsa në punë vazhdojnë te mbesin **12 mijë e 956**.

Është me rendësi të theksohet se në vitin 2018, Gjykata e Apelit ka zgjidhur 1750 lëndë me shumë se në vitin 2017. Dhe mbi 3 mijë lëndë më shumë se në vitin 2016. Kjo është bërë me një staf pothuajse të njëjtë të gjyqtarëve.

Në vijim në formë tabelore janë paraqitur, numri i gjyqtarëve gjatë viteve 2013-2018 dhe numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj kohe.

<u>Viti</u>	<u>Nr. i gjyqtarëve</u>	<u>Lëndët e zgjidhura</u>
2013	<b>34</b>	11 mijë 375 lëndë
2014	<b>32</b>	11 mijë 407 lëndë
2015	<b>37</b>	10 mijë 867 lëndë
2016	<b>34</b>	10 mijë e 534 lëndë
2017	<b>35</b>	11 mijë e 890 lëndë
2018	<b>36<sup>1</sup></b>	13 mijë e 648 lëndë

*Tabela :1 Numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e gjyqtarëve gjatë viteve 2013-2018*

Fatkeqësisht shumica e lëndëve të mbetura, 11 mijë e 552, janë të lemisë civile, ku kemi akoma raste të pa përfunduara nga vitit 2014.

<sup>1</sup> Në këtë shifër nuk janë llogaritur edhe 5 gjyqtarë të Divizionit në Mitrovicë. Ky divizion do të trajtohet në një pjesë të veçantë.

Në vijim ju njohim më hollësisht lidhur më numrin e lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura gjatë një viti.

Ankesa Civile (AC dhe CN), nga viti 2017 janë trashëguar 11,325 lëndë, në 2018 janë pranuar 5,687, janë kryer 5,460, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 11,552 lëndë, apo vetëm 228 më shumë se në fillim të vitit.

Ankesa Ekonomike (AE dhe EN), nga viti 2017 janë trashëguar 340 lëndë, në vitin 2018, janë pranuar 340. Nga to janë kryer 237, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 443 lëndë, apo 203 lëndë më shumë se në fillim të vitit.

Ankesa Penale (PA1) nga viti 2017 janë trashëguar 379 lëndë, janë pranuar gjatë viti 2018 edhe 1,357. Prej tyre janë zgjidhur 1,446, ndërsa vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 290 lëndë, apo 89 lëndë më pak se në fillim të vitit.

Ankesa Penale Krime të Rënda (PAKR), nga viti 2017 janë trashëguar 79 lëndë, janë pranuar në vitin 2018 edhe 636, janë zgjidhur 623, ndërsa vazhdojnë te mbasin ne pune 92 lëndë. Kemi një rritje të vogël prej 13 lëndëve, në krahasim më fillimin e vitit.

Ankesa Penale për të Mitur (PAM), nga viti 2017 janë trashëguar vetëm 3 lëndë, janë pranuar gjatë vitit 2018 edhe 92, prej tyre janë zgjidhur 92, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 3 lëndë.

Penale të Ndryshme (PN), janë trashëguar nga viti paraprak, 21 lëndë, janë pranuar në 2018, 1,325, janë zgjidhur 1,255, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 91 lëndë, 70 më shumë se ne fillim të vitit.

Penale Paraburgime (KP), nga viti 2017 janë trashëguar 3 lëndë, janë pranuar 2599, janë zgjidhur 2600, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 2 lëndë, një më pak se në fillim të vitit.

Ankesa Administrative (AA), janë trashëguar nga viti 2017, 418 lëndë, janë pranuar 655, janë kryer 747, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 335 lëndë, 83 më pak se sa në fillim të vitit.

Kundërvajtje(AK) janë trashëguar nga viti 2017, 8 lëndë, janë pranuar në 2018, 1,327, janë kryer 1,187, vazhdojnë te mbasin ne pune edhe 148 lëndë, 140 më shumë.


Këto të dhëna mund t'i shihni edhe në formë tabelore dhe grafike në faqet në vijim.

Ankesa	PENALE KRIME TE RENDA	EKONOMIKE	ADMINISTRATIVE	PENALE PËR TË MITUR	DEP PERGJ PENALE	DEP PERGJ CIVILE	DEP PËRGJ KUNDERVAJTJE	PENALE NDRYSHME	PARABURGIME	Gjithsej
Të trashëg.	79	340	418	3	379	11325	8	21	3	<b>12576</b>
Të pranuar gjatë 2018	636	340	665	92	1357	5687	1327	1325	2599	<b>14028</b>
Gjithsej në punë	<b>715</b>	<b>680</b>	<b>1083</b>	<b>95</b>	<b>1736</b>	<b>17012</b>	<b>1335</b>	<b>1346</b>	<b>2602</b>	<b>26604</b>

Tab 2: Lëndet e trashëguera nga 2017 dhe lëndet e pranura 2018

Ankesa	PENALE KRIME TE RENDA	EKONOMIKE	ADMINISTRATIVE	PENALE PËR TË MITUR	DEP PERGJ DV PENALE	DEP PERGJ DV CIVILE	DEP PËRGJ DV KUNDERVAJTJE	PENALE NDRYSHME	PARABURGIME	Gjithsej
Lëndë të cilat kanë qenë në punë gjatë 2018	715	680	1083	95	1736	17012	1335	1346	2602	<b>26604</b>
Të zgjidhura gjatë 2018	623	237	748	92	1446	5460	1187	1255	2600	<b>13648</b>
Të pa Zgjidhura në fund të 2018	<b>92</b>	<b>443</b>	<b>335</b>	<b>3</b>	<b>290</b>	<b>11552</b>	<b>148</b>	<b>91</b>	<b>2</b>	<b>12956</b>

Tab 3: Lëndët në punë dhe lëndët e zgjidhura në 2018



Grafikoni 1. Lëndët e pranuar dhe të zgjidhura gjatë vitit 2018

Ne total, Gjykata e Apelit ne vitin 2018 ka hyre me 12,576 lëndë të pazgjidhura, gjate vitit 2018 janë pranuar edhe 14,028 lëndë, numër ky më i larti i shënuar ndonjëherë. Nga to gjykata ka arritur t'i zgjidh 13,648 lëndë, kanë mbetur 12,956 lëndë, diku 380 lëndë më shumë se sa në fillim te vitit. Nga kjo shifër rezulton se në përgjithësi gjykata ka arritur t'i zgjidh 97.3% të lëndëve të pranuar.

Është më rëndësi, ti shohim edhe disa krahasime sa i përket lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura gjatë të dy viteve të fundit, si dhe të nxjerrim dallimin në mes tyre.

Ankesa Civile gjate vitit 2017 janë pranuar 5,863 lëndë, janë kryer 4,400. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 5,687 lëndë, janë kryer 5,460. Nga kjo del se kemi zgjidhur 1,060 lëndë me shume.

Ankesa Ekonomike gjate vitit 2017 janë pranuar 342 lëndë, janë kryer 249. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 340 lëndë, janë kryer 237, apo 12 lëndë më pak.

Ankesa Penale gjatë vitit 2017 janë pranuar 1,373 lëndë, janë kryer 1,602. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 1,357 lëndë, janë kryer 1,446. Pra në vitin 2018 janë zgjidhur 156 lëndë me pak.

Ankesa Penale Krime te Renda gjate vitit 2017 janë pranuar 591 lëndë, janë kryer 702. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 636 lëndë, janë kryer 623 .Edhe këtu kemi të zgjidhura 79 lëndë me pak.

Ankesa Penale për te Mitur gjatë vitit 2017 janë pranuar 76 lëndë, janë kryer 74. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 92 lëndë, janë kryer 92. Kjo do të thotë se janë zgjidhur 18 lëndë më shumë.

Ankesa Penale te Ndryshme gjate vitit 2017 janë pranuar 1,081 lëndë, janë kryer 1,075. Gjatë e vitit 2018 janë pranuar 1,325 lëndë, janë kryer 1,255. Kemi të zgjidhura 180 lëndë me shumë.

Ankesa Penale Paraburgime gjate vitit 2017 janë pranuar 2,386 lëndë, janë kryer 2,387. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 2,599 lëndë, janë kryer 2,600. Po ashtu kemi një shifër të lëndëve të zgjidhura 213 lëndë me shumë.


278 lëndë me shumë të zgjidhura kemi edhe tek Ankesat Administrative. Gjate vitit 2017 janë pranuar 554 lëndë, janë kryer 472. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 665 lëndë, janë kryer 748.

Më shumë lëndë kemi zgjidhur edhe në Kundervajtje. Këtu gjate vitit 2017 janë pranuar 934 lëndë, janë kryer 929. Gjate vitit 2018 janë pranuar 1,327 lëndë, janë kryer 1,187. Dallimi: 258 lëndë me shume.

Në vijim mund të shihni se si duken këto krahasime në formë tabelore dhe grafike.

Ankesa	PENALE KRIME TE RENDA	EKONOMIKE	ADMINISTRATIVE	PENALE PËR TË MITUR	DEP PERGJ DV PENALE	DEP PERGJ DV CIVILE	DEP PËRGJ DV KUNDERVAJTJE	PENALE NDRYSHME	PARABURGIME	Gjithsej
Të zgjidhura gjatë 2017	702	249	472	74	1602	4400	929	1075	2387	<b>11890</b>
Të zgjidhura gjatë 2018	623	237	748	92	1446	5460	1187	1255	2600	<b>13648</b>
Gjithsej në punë për 2019	<b>79</b>	<b>12</b>	<b>-276</b>	<b>-18</b>	<b>156</b>	<b>-1060</b>	<b>-258</b>	<b>-180</b>	<b>-213</b>	<b>-1758</b>

Tab 3:Krahasimi i lëndve të zgjidhura 2017-2018



Grafikoni 2. Krahasimi i lëndëve të zgjidhura 2017-2018

## II. ORGANIZIMI I PUNËS

### 1. Gjyqtarët, vështrim i përgjithshëm

Gjykata e Apelit e ka filluar më 35 gjyqtarë , përfshi edhe kryetarin e gjykatës. Më 12 shkurt, Rasim Rasimi dhe Ragip Namani, transferohen në Gjykatën Supreme ndërsa gjyqtarja Mediha Jusufi, e arrin moshën e pensionimit. Një javë më vonë, në gjykatë fillojnë punën pesë gjyqtarë të rinj: Afrim Shala, Burim Shala, Delushe Halimi, Valon Totaj dhe Lumni Sallauka. Me 1 mars, gjyqtari Isa Shala, jep dorëheqje nga pozita e tij. Pas këtyre ndryshimeve numri i gjyqtarëve arriti në 36, numër ky i cili nuk do të ndryshoj gjatë tërë vitit .

#### 1.1. Përbërja dhe organizimi i punës

Puna në Gjykatën e Apelit zhvillohet në pesë departamente dhe tri divizione dhe atë : **Departamenti i Përgjithshëm** i ka pasur 25 gjyqtarë, të ndarë në tri divizione. Divizioni civil, divizioni penal dhe divizioni për kundërvajtje.

- Në *Divizionin për çështje civile*, kanë punuar 17 gjyqtarë në 6 kolegje profesionale.
- Në *Divizionin për çështje penale*, 6 gjyqtarë në 2 kolegje profesionale.
- Në *Divizionin për Kundërvajtje* , 2 gjyqtarë. Kolegji është plotësuar nga një gjyqtar i *Departamentit Administrativ*.

**Në Departamentin për Krime të Rënda**, kanë qenë të sistemuar 7 gjyqtarë, të cilën punën e kanë zhvilluar në tri kolegje. Një gjyqtar nga departamentit të përgjithshëm , i ka plotësuar kolegjet dy dhe tre, por nuk është ngarkuar më lëndë.

**Në Departamentin për Çështje Ekonomike** ka punuar vetëm një gjyqtar. Kolegji është formuar më dy gjyqtar të divizionit civil nga departamenti i përgjithshëm.

**Në Departamenti për Çështje Administrative** kanë qenë të sistemuar 2 gjyqtarë, të cilët kolegjin e plotësojnë me një gjyqtarë nga divizioni civil i Departamentit të Përgjithshëm.

**Në Departamenti për të Mitur**, kanë punuar 2 gjyqtarë, të cilët për shkak të numrit të vogël të lëndëve janë përcaktuar që të gjykojnë edhe çështje nga Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal. Kolegji formohet më një gjyqtar të Departamentit për Krime të Rënda.

#### 2. Personeli administrativ

Për kryerjen e punëve administrative, të mbështetjes ligjore, financa, logjistike, dhe punët teknike aktualisht janë të angazhuar 85 punëtorë, duke e përfshirë edhe administratorin. Zyra për mbështetje ligjore, përbehet nga 12 bashkëpunëtorë profesional dhe 15 zyrtarë ligjor. Po ashtu gjykata në periudha të caktuara është ndihmuar nga UNDP më 6 zyrtarë ligjorë dhe GIZ-i, me 2.

Në sektorët tjerë të administratës nuk ka pas mungesa që do ta cenonin vijueshmërinë normale të punës.



## **2.1. Rekrutimet dhe avancimet**

Në shtator, Gjykata e Apelit ka rekrutuar 10 zyrtarë ligjor. Greta Ibraj, Alba Makolli, Rajmonda Kurteshi, Ardianë Morina, Bekrie Rexha, Sllazhana Joviç, Kushtrim Gashi, Vilson Maloku, Anduena Gashi dhe Rrezarta Balaj. Në muajin shkurt, përmes konkursit të brendshëm Arber Jashari nga pozita Zyrtar për Informim dhe Monitorim, është avancuar në Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional.

## **2.2. Me kontratë të përkohshme**

Me mbështetjen e GIZ-it gjerman, në shtator të vitit 2018, me kontratë të përkohshme janë angazhuar zyrtarët ligjor Visar Gashi dhe Arjeta Sylja. Ndërsa dy muaj më vonë përmes UNDP-së, po ashtu me kontrata të përkohshme, janë pranuar 6 zyrtarë ligjor. Merita Bogaj, Mirjeta Himaj, Shaban Prekalla, Blerta Isufi, Fitore Gjokaj dhe Valmir Bytyqi. Gjykata e Apelit ka rekrutuar gjatë vitit 2018 rreth 40 praktikantë gjyqësor.

## **2.3. Largimet**

Në gusht, zyrtari i IT Labinot Ismajli, ka dhënë dorëheqje. Në dhjetor është pensionuar referenti Asllan Rusinovci. Largimi i tyre nuk ka ndikuar në mbarëvajtjen e punës.

## **III. DIVIZIONI I GJYKATËS SË APELIT NË MITROVICË**

Në përputhje me Marrëveshjet e Brukselit dhe Shtojcën e Rregullores së KGJK-së për Organizmin e Brendshëm të Gjykatave, gjatë 2018-tës është bërë plotësisht funksional Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, i cili përbehet nga 7 gjyqtar. Dy gjyqtar të cilët janë nga komuniteti shqiptar, gjykojnë edhe në Gjykatën e Apelit të Kosovës, selia në Prishtinë. Atje janë caktuar dy kolegje civile dhe një penal. Ndërsa në dhjetor është arritur marrëveshja, që lëndët e 6 komunave jugore me shumicë serbe, të gjykohen në Prishtinë nga kolegje të përbëra me 2 gjyqtar të komunitetit serb dhe 1 shqiptar. Lëndët gjykohen si Gjykatë e Apelit e Kosovës, jo si Divizion. Për këtë janë caktuar 2 kolegje.

Vlen të theksohet se ky divizion është përballur me mungesë të madhe të lëndëve dhe se kontributi i gjyqtarëve në numrin total të lëndëve të zgjidhura ka qenë tepër modest, 79. Prandaj për të pasur një perceptim real të situatës dhe për të qenë më korrekt në krahasimin e viteve, kemi vendosur që të mos i përfshijmë në tabelën nr. 1.

Në Divizionin në Mitrovicë, janë të angazhuar edhe një staf administrativ prej 11 vetash, duke e përfshirë edhe ndihmës administratoren e gjykatës.

#### **IV. PRAKTIKA GJYQËSORE**

Gjatë këtij viti një vëmendje e veçantë i është kushtuar unifikimit të praktikës gjyqësore. Më planin e punës për vitin 2018, janë caktuar gjyqtarët përgjegjës për përcjelljen e praktikës gjyqësore nga të gjitha departamentet dhe ata gjatë punës së tyre janë kujdesur që vendimet gjyqësore të miratuara nga kolegje të ndryshme të departamentin ose divizionin përkatës, të jenë unike nëse fjala është për çështje që janë identike nga aspekti faktik e juridik.

Në këtë drejtim, në raste të caktuara, çështjet që kanë qenë diskutabile janë diskutuar edhe në nivel të departamentit të caktuar në mënyrë që qëndrimet të unifikohen.

Me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore gjatë vitit 2018, ekipe të gjyqtarëve të departamenteve përkatëse (civile, penale dhe administrative) kanë kryer vizita dhe kanë organizuar tryeza diskutimi me gjyqtarë e departamenteve përkatëse në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Prizrenit, Ferizajt, Gjakovës dhe Mitrovicës . Në të gjitha këto takime janë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me unifikimin e praktikave gjyqësore në gjykatat themelore të Kosovës. Projekti është përkrahur nga OSBE-ja. Në lëmine penale, temë diskutimi ka qenë harmonizimin e politikës ndëshkimore dhe hudhjen e aktakuzave. Ndërsa në atë civile kontestet pronësore dhe trajtimin e rasteve më urdhër mbrojtje.

#### **V. LËNDËT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE RASTET E SHENJESTRUARA**

Janë lëndë të cilat kjo gjykatë i ka shqyrtuar me prioritet të plotë. Nga viti 2017 kemi trashëguar 16 kundër korrupsionit zyrtar. Gjatë vitit që lamë kemi pranuar edhe 109 lëndë. Që do të thotë se i kemi pasur në punë 125 raste. Janë kryer 107, ndërsa vazhdojnë të mbesin në punë edhe 18.

Sa u përket lendeve të shenjestrura, Gjykata e Apelit i ka kryer të gjitha brenda një afati të shkurtër.

#### **VI. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI**

Krahas punëve që janë bërë në zgjidhjen e lëndëve nga kompetenca e kësaj gjykate, këtë vit ka vazhduar rritja e transparencës, komunikimit më të mirë me palët, median dhe publikun.

Është përmirësuar në masë të konsiderueshme edhe komunikimi brenda kësaj gjykate, por edhe me gjykatat tjera.

Këtë vit përmes Zyrës për informim janë publikuar rregullisht Oraret e seancave, në web-portalin e gjykatë. Janë publikuar në web-portal **rreth 700** vendime të Gjykatës së Apelit, duke e rritur numrin e përgjithshëm në 1.000. Janë leshur dhe publikuar në web-portal mbi **60** komunikata lidhur me rastet me specifike dhe veprimtarinë e gjykatës. Është organizuar një konferencë për medie.

Gjithashtu kryetari i Gjykatës së Apelit, në vazhdimësi i është përgjigjur interesit të mediave për tema të ndryshëm.

## **VII. OBJEKTIVAT**

Për vitin 2019, objektivi kryesor është zvogëlimi i lëndëve të pa përfunduara dhe aruzhimi sa më i shpejtë i tyre, sidomos në lëmine civile dhe ekonomike. Deri në fund të vitit 2019 synojmë që t'i zgjidhim të gjitha lëndët e prapambetura civile të vitit 2014 dhe 2015 si dhe lëndet e natyrës urgjente.

Krahas sasisë, objektivi kryesor i kësaj gjykate mbetet përmirësimi i cilësisë në vendimmarrje dhe interpretimi unik i ligjit. Gjykata do të vazhdojë takimet me gjykatat themelore dhe do të organizojë kolegji me profesionale me gjyqtarët e vet.

Po ashtu do të punojmë në plotësimin e vendeve të lira në administratë

Prishtinë, 2018

Kryetari i Gjykatës së Apelit

Hasan Shala